

NDIKIMI I TVSH-SË NË BUXHETIN E FAMILJES NË QYTETIN E KORÇËS

Marsida HARREMI

Silvia GOÇI

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit

Fakulteti i Ekonomisë

Universiteti “Fan S. Noli”

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që të analizojmë të gjitha burimet e informacionit në lidhje me kuadrin ligjor, administratën tatimore, marrdhëniet tatimpagues-administratë tatimore, të performancës së tyre në realizimin e të ardhurave publike, si dhe rolin e shtetit në shpërndarjen e të ardhurave. Realizimin i një studimi për ndikimin e normës së TVSH-së në buxhetin familjar në qytetin e Korçës dhe nxjerrja e përfundimeve për përmirësimin e sistemit tatimor në të ardhmen. Metodologjia e përdorur ë metoda e grumbullimit, seleksionimit, përpunimit, vlerësimit, metoda e analizës përshkuese dhe krahasuese e të dhënave, për një periudhë një vjeçare. Disa përfundime janë arritur mbi efikasitetin e sistemit tatimor dhe rëndësinë që kanë tatimet dhe taksat në të ardhurat publike dhe në buxhetin familjar. Gjatë përpunimit dhe analizës së të dhënave vërejmë se normat e tatim-taksave që aplikohen në vendin tonë janë shumë të larta, të cilat kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve mujore për konsum dhe uljen e nivelit të kursimeve.

Fjalë kyçe: Politika fiskale, sistem tatimor, TVSH-ja, të ardhurat tatimore, të ardhurat personale, administratë tatimore.

Abstract

The purpose of this paper is to analyze all sources of information regarding the legal framework, tax administration, taxpayer-tax administration relations, their performance in the realization of public revenues, as well as the role of the state in the distribution of revenues. Carrying out a study on the impact of the VAT rate on the family budget in the city of Korça and drawing conclusions for the improvement of the tax system in the future. The methodology used is the method of collection, selection, processing, evaluation, the method of penetrating and comparative data analysis, for a period of one year. This methodology has helped to reach some conclusions about the efficiency of the tax system and the importance of taxes and duties in public income and in the family budget. During the processing and analysis of the data, we notice that the tax rates applied in our country are very high, which has influenced the increase in monthly consumption expenses and the decrease in the level of savings.

Keywords: *Fiscal policy, tax system, VAT, tax income, personal income, tax administration.*

1. HYRJJE

Kur flitet për një sistem tatimor, gjithmonë duhet marrë parasysh realiteti në të cilin ai zbatohet. Nga njëra anë ka një kufi hapësire sepse çdo vend ka specifikat e tij dhe nga ana tjetër ka dhe një kufi kohor sepse ai zbatohet në një periudhë të caktuar. Sistemi tatimor në vendin tonë, si gjithë reformimi i sistemit politik dhe ekonomik, pas viteve 1990 ka kaluar nëpërmjet shumë vështirësish e pengesash, si: krizë e thellë ekonomike dhe financiare, mungesë e kuadrit ligjor për ekonominë e tregut, njohje e kufizuar e ekonomisë së tregut, rrënjosja e idesë se Shqipëria ishte i vetmi vend pa “tatime dhe taksa”, mungesë e legjislacionit tatimor, etj. Shteti nëpërmjet politikave tatimore përpiqet të harmonizojë legjislacionin fiskal në vend me ato të BE-së.

Vitet e fundit vëmendje e veçantë i është kushtuar administrimit fiskal, konsolidimit të administratës tatimore dhe bashkëpunimit me komunitetin e biznesit. Studimi dhe analizimi i sistemit tatimor ka një rëndësi të madhe për ndikimit që ka pasur në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqënies së qytetarëve shqiptar. Për efekt studimi tema është ndarë në disa kapituj. Në fillim do të ndalemi në analizimin dhe sqarimin e koncepteve kryesore të sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë. Do të kalojmë në vështrim më të detajuar se si ka ndikuar sistemi tatimor në rritjen ekonomike në përgjithësi dhe ndikimi i TVSH-së në të ardhurat publike dhe ndikimi i saj në buxhetin e familjes. Në funksion të këtij studimi kemi bërë një trajtim të shkurtër të historikut të sistemit tatimor në vendin tonë. Gjithashtu jemi ndalur në disa trajtime teorike dhe analiza e krahasime mbi llojet e tatim-taksave që aplikohen në vendin tonë, në rajon dhe disa vende të BE.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij studimi është të analizojmë të dhënat e nxjerra nga pyetësi mbi ndikimin që ka pasur TVSH-ja në konsumin mujor familjar në qytetin e Korçës. Të identifikojmë problemet dhe se çfarë mund të bëjë qeveria në drejtim të rritjes së mirëqënies së qytetarëve.

2.1 OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i këtij studim është të njohë dhe studiojë me detaje nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve mujore të familjeve në qytetin e Korçës dhe

si ka ndikuar TVSH-ja në rritjen e konsumit familjar.

- Të marrim informacionin mbi ndikimin e TVSH-së në rritjen e nivelit ekonomik të familjeve në qytetin e Korçës.
- Të përpunojmë e analizojmë të dhënat dhe nëpërmjet krahasimit të rezultateve të evidentojmë gjendjen reale ekonomike të familjes.
- Të përpunojmë të dhënat dhe të analizojmë ndikimin që ka TVSH-ja në rritjen e konsumit dhe kursimeve.
- Të arrijmë në disa përfundime dhe rekomandime për strukturat përgjegjëse qeveritare.

3. METODOLOGJIA

Metodologjia e realizimit të studimit bazohet në analizimin dhe krahasimin e të dhënave mbi ndikimin e TVSH-së në buxhetin e familjes në qytetin e Korçës. Mbështetur në rezultatet e të dhënave të siguruara nga pyetësorët kemi bërë analizimin dhe krahasimin e tyre nga të dhënat e marra nga burime të tjera, si INSTAT, etj., si dhe me anë të regresionit të thjeshtë.

Për të marrë informacion dhe analizuar situatën aktuale të nivelit të shpenzimeve të qytetarëve në qytetin e Korçës u hartua një pyetësor drejtuar qytetarëve (200 qytetarë). Pyetësi është i përbërë nga 15 pyetje.

Të dhënat u analizuan përmes programit Software EView 13 dhe paraqiten në tabela dhe grafikët përmes analizës përshkruese. Për të testuar nëse variablat e pavarur të përfshirë në studim parashikojmë statistikisht variablat e varur përdorën modelet e regresionit të thjeshtë.

Popullsia e qytetit të Korçës, sipas censusit të fundit 2023 përbëhet nga rreth 60,754 banorë. Të intervistuarit janë banorë të qytetit të Korçës. Për përpunimin e të dhënave është zgjedhur formula e përpunuar nga Yamane 1967.

$$n = \frac{N}{1 + N(e)^2}$$

n = madhësia e kampionit të kërkuar.

e = kufiri i gabimit.



N = madhësia e popullatës.

Në këtë studim janë përfshirë 200 qytetarë. Madhësia e kampionit sipas popullsisë dhe individëve të marrë në studim është:

$$n = \frac{60,754}{1 + 60,754(0.1)^2} = 99.8$$

4. ANALIZA E REZULTATEVE TË ANKETIMIT



1. Gjinia



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Të anketuarit ishin të moshave, gjinive dhe profesioneve të ndryshme që banojnë në lagje të ndryshme të qytetit të Korçës. Të intervistuarit sipas gjinisë janë 53% meshkuj dhe 47% femra.



2. Moshë.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Sipas grupmoshave 13% janë të moshës 25-30 vjeç, 23% janë të moshës 30-40 vjeç, 25% janë të moshës 40-50 vjeç përbën numrin më të madh të anketuarve, 21% janë të moshës 50-60 vjeç dhe 18% mbi 60 vjeç.

3. Niveli arsimor.





*Burimi:
Të dhëna*

20

na të përpunuara nga autori, 2024.

Përsa i përket nivelit arsimor, me arsim të ulët që përfshin atë 8-9 vjeçar janë 13% e të anketuarve, me arsim të mesëm janë 38% dhe atë të lartë janë 49%. Mostra e zgjedhur për anketim qëllimisht përfshin numër të lartë të individëve me nivel të lartë arsimor në funksion të qëllimit të studimit.

4. Statusi.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024


Sipas statusit 21% janë beqar, të martuar 70%, të divorcuar 5% dhe të ve 4%.

5. Numri i anëtarëve të familjes.





Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Numri antarëve



të familjes varion nga 1 deri më shumë se 5 anëtarë. Me 1 anëtar 6%, 2, anëtarë 17%, 3 anëtarë 13%, 4 anëtarë 51%, 5 anëtarë 9% dhe mbi 5 anëtarë 4%.



6. Të ardhurat mujore mijë/lekë për familje.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Të ardhurat mujore 30-40 mijë lekë janë 1% e të anketuarve; 40-50 mijë lekë 2%; 50-60 mijë lekë 7%; 60-70 mijë lekë 19%; 70-80 mijë lekë 31%, përbën numrin më të madh të anketuarve, 80-90 mijë lekë 21% dhe mbi 90 mije lekë 19%.


7. Niveli TVSH-së 20%.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Rreth 78% e të anketuarve shprehen se niveli TVSH prej 20% është i lartë, ky nivel prek kryesisht shtresat e varfëra dhe në nevojë, ndërsa 10% shprehen se ky nivel TVSH-je është normal dhe 12% shprehen se është i ulët.



8. Ndikimi i TVSH-së në vendimet për blerje.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Në pyetjen që u drejtua të anketuarve se a ndikon TVSH në marrjen e vendimit për blerje janë këto të dhëna; 91% shprehen se ndikon dhe 9% shprehen se nuk ndikon.



9. Shpenzimet mujore.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Sipas rezultateve 1% e të anketuarve harxhojnë 30-40 mijë lekë, 2% harxhojnë 40-50 mijë lekë, 9% harxhojnë 50-60 mijë lekë, 19% harxhojnë 60-70 mijë lekë, 32% harxhojnë 70-80 mijë lekë, 20% harxhojnë 80-90 mijë lekë dhe 17% harxhojnë mbi 90 mijë lekë.



10. Janë të mjaftueshme të ardhurat mujore.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Ndërsa pyetjes se a janë të mjaftueshme të ardhurat mujore, 84% përgjigjen se nuk janë të mjaftueshme dhe vetëm 16% përgjigjen që janë të mjaftueshme.



11. Ndikimi TVSH-së në shpenzimet.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Pyetjes së radhës për ndikimin e TVSH në rritjen e shpenzimeve 86% shprehen se janë rritur shpenzimet mujore dhe 14% shprehen se ato janë ulur.


12. Ndikimi TVSH në grupet e konsumit.




Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Ndërsa pyetjes se cili nga grupet kryesore të konsumit preket më shumë nga TVSH-ja, 61% përgjigjen se më shumë preket grupi ushqime pije jo-alkolike, 11% shpenzimet për ujë, 12% energji elektrike dhe të tjerat më pak.

13. Ndikimi TVSH në konsum.







Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Pyejtes se a ndikon TVSH në rritjen apo uljen e konsumit, 78% shprehen se ndikon në uljen e konsumit dhe 22% në rritjen e konsumit. Sipas të dhënave është ulur konsumi në familje.

14. Duhet të ndërhyjë qeveria në uljen e TVSH.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

90% e të anketuarve shprehen se qeveria duhet të ndërhyjë dhe 10% përgjigjen nuk duhet të ndërhyjë.

15. Ndikimi TVSH në nivelin e kursimeve.



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.


Shumica e të anketuarve, 96% e tyre shprehen se ulja e TVSH-së do të

ndikojë në nivelin e kursimeve dhe 4% shprehen se nuk do të ndikojë.

5. SHPENZIMET MUJORE TË FAMILJES NË QYTETIN E KORÇËS

Sipas të dhënave të marra nga pyetësi drejtuar qytetarëve, shpenzimet mesatare mujore për një familje janë rritur. Një familje me 3.8 anëtarë në Qytetin e Korçës, sipas grupeve kryesore të konsumit harxhon mesatarisht 75700 lekë në muaj.

Grafik 1: Shpenzimet mujore, Histograma e shpërndarjes së vlerave



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024

Sipas llogaritjeve të paraqitet në të dhënat e mëposhtme:

Tabela 1: Pësja në % e grupeve kryesore të konsumit ndikimi i TVSH-së


Grupet kryesore të konsumit	%	Shpenzimet	Me TVSH	Pa TVSH	TVSH/lekë
Ushqim dhe pije jo-alkolike	39.7	75700	30052.9	24042.4	6010.6
Pije alkoolike, duhan	4.2	75700	3179.4	2543.5	635.9
Veshje dhe Këpucë	5.0	75700	3785.0	3028.0	757.0
Banesën, ujë, e. elektrike, qira.	9.8	75700	7418.6	5934.7	1483.7
Mobilim, pajisje, mirëmbajtje.	6.5	75700	4920.5	3936.4	984.1
Shëndet	4.3	75700	3255.1	2604.1	651.0
Transport	6.9	75700	5223.3	4178.7	1044.6
Komunikim	3.9	75700	2952.3	2361.8	590.5
Argëtim dhe kulturë	2.7	75700	2043.9	1635.1	408.8
Arsim	3.5	75700	2649.5	2119.6	529.9
Restorante dhe hotele	7.3	75700	5526.1	4421	1105.2

Të tjera mallra dhe shërbime	6.2	75700	4693.4	3754.7	938.7
Shuma	100	75700	75700	60560	15140

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Sipas rezultateve të nxjerra nga pyetësorët të ardhurat mesatare mujore nga pagat dhe burime të tjera për familje në qytetin e Korçës janë 76600 lekë. Të ardhurat mujore mesatare janë 900 lekë më shumë krahasuar me shpenzimet mesatare mujore. Nga këto të dhëna nxjerrim si përfundim se niveli i kursimeve për familje është shumë i ulët.

Grafik 2: Histograma e shpërndarjes së vlerave



Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Gjatë analizës së shpenzimeve në vlera monetare dhe në % vëmë re se një shumë e konsiderueshme shkon për TVSH-në. Shteti i merr qytetarëve vetëm nga TVSH, rreth 15140 lekë në muaj që zë rreth 19.9% të shpenzimeve mesatare mujore për familje. Kjo është një shifër shumë e lartë për një buxhet familjar, sidomos për shtresat në nevojë. Një familje në qytetin e Korçës paguan mesatarisht për TVSH 15140 lekë në muaj x 12 muaj = 181680 lekë në vit. Reduktim i normës së TVSH-së me 50% do të ishte një mbështetje për qytetarët.

Në vijimësi do të trajtohet analiza e regresionit.

Regresion 1. Rritja e shpenzimeve mujore = C(1) + C(2) rritja e të ardhurave.

Dependent Variable: SH M
Method: Least Squares (Gauss-Newton / Marquardt steps)
Date: 07/04/24 Time: 12:40
Sample: 1 200
Included observations: 200
SH M=C(1)+C(2)*TR

	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C(1)	654.3548	1188.359	0.550637	0.5825
C(2)	0.979708	0.015287	64.08782	0.0000
R-squared	0.954010	Mean dependent var		75700.00
Adjusted R-squared	0.953777	S.D. dependent var		13319.05
S.E. of regression	2863.522	Akaike info criterion		18.76744
Sum squared resid	1.62E+09	Schwarz criterion		18.80043
Log likelihood	-1874.744	Hannan-Quinn criter.		18.78079
F-statistic	4107.249	Durbin-Watson stat		0.482900
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

Ho: Rritja e të ardhurave mujore ndikon në rritjen e shpenzimeve mujore.

Kjo hipotezë vërtetohet:

Modeli i parë i regresionit të thjeshtë linear jep lidhjen midis rritjes së shpenzimeve, variabël i varur – Y dhe rritjes së të ardhurave, variabël i pavarur – X .

Ky model është: $Y = 654.4 + 0.98 X_1$. Ky model paraqitet i rendësishëm $t = 64.1$; $p < 0.05$ me një fuqi shpjeguese 95%; $R^2 = 0.95$.

Regresioni 2. Rritja e shpenzimeve pa vlerën e TVSH = C(1) + C(2) vlera e TVSH-së.

Ho: Vlera e TVSH-së ka ndikimi statistikisht të rëndësishëm te shpenzimet pa vlerën e saj.

Kjo hipotezë vërtetohet;

Modeli i dytë i regresionit të thjeshtë linear jep lidhjen midis shpenzimeve pa vlerën e TVSH, variabël e varur – Y dhe vlerës së TVSH, variabël i pavarur – X .

Ky model është: $Y = -20.6 + 4.03 X_1$. Ky model paraqitet i rendësishëm $t = 21.9$; $p < 0.05$ me një fuqi shpjeguese 100 %; $R^2 = 1.0$.

Nga kjo analizë dalim në përfundimin se rritja e normës së TVSH-së ndikon në rritjen e shpenzimeve. Për këtë arsye rekomandojmë uljen e normës së TVSH-së, sidomos për produktet ushqimore, që përbëjnë grupin e konsumit që ndikohet më shumë nga norma e TVSH-së.

Grafik 3: Analiza e Regresionit të thjeshtë linear

Dependent Variable: SH_PTVSH

Method: Least Squares (Gauss-Newton / Marquardt steps)

Date: 07/04/24 Time: 12:29

Sample: 1 200

Included observations: 200

SH_PTVSH=C(1)+C(2)*TVSH

	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C(1)	-20.57153	0.634089	-32.44266	0.0000
C(2)	4.025237	0.000184	21.93329	0.0000
R-squared	1.000000	Mean dependent var		12017.18
Adjusted R-squared	1.000000	S.D. dependent var		6982.784
S.E. of regression	4.491085	Akaike info criterion		5.852015
Sum squared resid	3993.629	Schwarz criterion		5.884998
Log likelihood	-583.2015	Hannan-Quinn criter.		5.865363
F-statistic	4.81E+08	Durbin-Watson stat		0.063992
Prob(F-statistic)	0.000000			

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori, 2024.

6. PËFUNDIME

Duke analizuar faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, ndikimin që kanë tatimet dhe taksat në mbledhjen e të ardhurave publike dhe rritjen e nivelit ekonomik të shtetasve arrijmë në përfundimin se:

1. Norma e TVSH-së prej 20% që aplikohet në vendin tonë është shumë e lartë krahasuar me vendet e rajonit, kjo normë është në të njëjtat nivele me normat e TVSH që aplikojnë disa shtete të zhvilluara të BE.
2. Shpenzimet mesatare mujore për konsum për një familje e përbërë prej 3.8 personash janë rritur me 4.5% krahasuar me vitin 2022. Ndikim të madh ka dhe norma e TVSH-së që aplikohet në vendin tonë.
3. Nga studimi i kryer në qytetin e Korçës del se të ardhurat mesatare mujore për familje nga pagat dhe burime të tjera janë afërsisht 76600 lekë, ndërsa shpenzimet mesatare mujore kapin shifrën 75700 lekë. Kjo tregon se niveli kursimeve është i papërfillshëm.
4. Nga anketimi del se 78% e të intervistuarve shprehen se niveli TVSH-së është i lartë dhe se 90% e tyre shprehen se qeveria duhet të ndërhyjë për uljen e saj.
5. Shteti ju merr qytetarëve vetëm nga TVSH-ja rreth 15140 lekë në muaj që zë rreth 19.9% të shpenzimeve mesatare mujore për familje.
6. Nga analiza e të dhënave të pyetësorit dalim në përfundimin se rritja e normës së TVSH-së ndikon në rritjen e shpenzimeve, sidomos për produktet ushqimore, që përbën grupin e konsumit që ndikohet më shumë nga norma e TVSH-së.

7. REKOMANDIME

1. Administrata tatimore për të rritur efikasitetin e saj duhet të përdorë sisteme moderne të informacionit dhe teknologjisë, të lehtësojë procedurat tatimore, të përmirësojë komunikimin me stafin dhe ti trajtojë tatimpaguesit si partnerë. Duke ju ofruar asistencën e nevojshme, transparencë dhe drejtësi në zbatimin e ligjit.
2. Norma e TVSH-së 20% është shumë e lartë për ekonominë në zhvillim dhe mirëqënien e qytetarëve, prandaj është e domosdoshme ndërhyrja e qeverisë për reduktimin e tyre, sidomos për produktet e shportës.
3. Për të inkurajuar investimet dhe zhvillimin ekonomik në vend mund të përdoren politika stimuluese, si ulje e tatimit mbi fitimin nën 15%, ose heqjen nga detyrimi tatimor për një periudhë të caktuar.
4. Përdorimi i taksave të ndryshme në bazë të produkteve ose shërbimeve për të ndikuar në konsumin e produktit të caktuar dhe për të promovuar sjellje të mira mjedisore.

8. REFERENCA

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (2023) “Legjislacioni Tatimor”.

<https://arkiva.financa.gov.al/legjislacioni-tatimor-2/>

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (2023) “Tatimet dhe taksat në RSh”.

<https://www.google.com/search?q=Drejtoria+e+P%C3%ABrgjithshme+e+Tatimeve+Tatimet+dhe+taksat+n%C3%AB+RSh%E2%80%9D>.

Eurostat (2022) “Shpenzimet e konsumit në Shqipëri”.

<https://www.google.com/search?q=Eurostat+%282022%29+%E2%80%9CShpenzimet+e+konsumit+n%C3%AB+Shqip%C3%ABri%E2%80%99>.

INSTAT (2023), “Shpenzimet e konsumit në Shqipëri”.

<https://www.google.com/search?q=INSTAT+Shpenzimet+e+konsumit+n%C3%AB+Shqip%C3%ABri>

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), “Financat Publike”, Neni 155, fq. 42.

Ministria e Financave (2008), “Sfidat e politikës fiskale në të ardhmen” Botim periodik i Ministrisë së Financave, Tiranë, fq. 3.

Ministria e Financave (2023), “Raportet vjetore”.

<https://file:///C:/Users/admin/Downloads/RAPORTI%20VJETOR%2020.pdf>